



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 580/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Arbëreshe Kryeziu Hyseni, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, për shkak të mungesës së votave në vendvotimin 0403D/02R në Gjilan, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.580/2021 i datës 04.03.2021, i paraqitur nga Arbëreshe Kryeziu Hyseni, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, për shkak të mungesës së votave në vendvotimin 0403D/02R në Gjilan, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.03.2021, ka pranuar apelin Anr.580/2021, nga Arbëreshe Kryeziu Hyseni, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se në vendvotimin me numër 0403D/02R në Gjilan, është bërë gabim teknik kur janë përshkruar votat në FPR. Parashtruesja e apelit pretendon se në këtë vendvotim ka vetëm 3 vota kurse në të gjitha klasat e tjera në këtë shkollë votat e saj janë si në vendvotimet me numër: 0403D-012 (89) vota, 0403D-03R (101) vota, 0403D-04R (105) vota, 0403D-05R (117) vota dhe 0403D-06R (99) vota. Më tutje pretendon se nuk është e mundur që në klasën 02R të ketë vetëm (3) vota. Parashtruesja e apelit pretendon se ka kontaktuar disa komisionerë të cilët e kanë konfirmuar gabimin, megjithatë kanë pasur frikë të deklarohen si dëshmitarë.

Paraqitësja e apelit, si dëshmi për të argumentuar pretendimet e saj, apelit i ka bashkangjitur një kopje të formularit të rezultateve të kandidates, në cilësi të provave materiale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi apelin, vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Arbëreshe Kryeziu Hyseni, e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), nuk është i bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave, përkatësisht mungesë të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.580/21 më datë 05.03.2021

Kryesues i Panelit

Adnan Konushevi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.